

VENDIM

Nr.213, datë 31.3.2010

PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË KOMITETIT KOMBËTAR TË TRASHËGIMISË KULTURORE SHPIRTËRORE DHE PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË TIJ

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komiteti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore të kryesohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe në përbërje të tij të jenë:

- | | |
|--|-----------|
| - Drejtori i drejtorisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore | sekretar; |
| - Përgjegjësi i sektorit për trashëgiminë kulturore | anëtar; |
| - Një specialist për trashëgiminë shpirtërore, pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore | anëtar; |
| - Sekretari i Komitetit Kombëtar të UNESCO-s, pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme | anëtar; |
| - Një specialist i muzikës popullore (etnomuzikolog) | anëtar; |
| - Një specialist i folklorit, gjuhës dhe dialekteve (etnolog) | anëtar; |
| - Një specialist i etnografisë, riteve dhe shfaqjeve popullore (etnograf) | anëtar; |
| - Një specialist i vallëzimit popullor dhe lojërave popullore (etnokoreolog) | anëtar; |
| - Një specialist i katalogimit të trashëgimisë shpirtërore (dixhitalizues) | anëtar; |
| - Një specialist i menaxhimit të trashëgimisë dhe turizmit kulturor (menaxher), | anëtar. |

2. Anëtarët e Komitetit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore, të përmendur në pikën 1, caktohen nominalisht me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore.

3. Mbledhjet e Komitetit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore thirren, si rregull, nga kryetari, jo më shumë se 4 herë në vit.

4. Anëtarët e këtij komiteti, të cilët nuk punojnë në sistemin e institucioneve shtetërore të specializuara, përfitojnë një shpërblim prej 5000 (pesë mijë) lekësh për çdo mbledhje.

5. Pagesa për shpërblimin të përballohet nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

6. Ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

7. Vendimi nr.723, datë 14.5.2008 i Këshillit të Ministrave "Për përbërjen e Komitetit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha